



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA FIER

Nr. 2343 prot.

Fier më 21/02/2025

PROJEKT – VENDIM

Nr. 21, datë 21/02/2025

**“Për një shtesë dhe disa ndryshime në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.141, datë 23.12.2024 “Për miratimin e bursave të shtetit, për nxënësit që ndjekin programet mësimore në arsimin bazë dhe të mesëm për vitin shkollor 2024-2025”**

Këshillit të Bashkisë Fier, sot më datë ....../....../2025, i paraqitet materiali për një shtesë dhe disa ndryshime në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.141, datë 23.12.2024 “Për miratimin e bursave të shtetit, për nxënësit që ndjekin programet mësimore në arsimin bazë dhe të mesëm për vitin shkollor 2024-2025” nga grupi i punës, i ngritur me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë Fier, Nr.439, Datë 15.10.2024 “Për shqyrtimin e dokumentacionit për studentët dhe nxënësit aplikant për të përfutur bursë”, pranë Bashkisë Fier, për nxënësit që plotësojnë plotësojnë kriteret e përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.666 datë 10.10.2019, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, përcaktimin e kriterëve për përfutimin e bursave dhe pagesave për përfutimin e bursave dhe pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike,” i ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 511 datë 27.07.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 666 datë 10.10.2019, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfutimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar si dhe format e tjera të përkujdesjes kategorive të vecanta në institucionet arsimore parauniversitare publike”.

Grupi i punës, bazuar në Ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; i ndryshuar, Ligjin nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, neni 2; Ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar, nenit 6; të ligjit nr.8153, datë 31.10.1996, “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar, nenit 8; të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbërit”, të ndryshuar, nenit 8; të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, nenit 12; të nenit 12 të ligjit 57/2019 “Per asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, si dhe kriterëve ligjore të përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 666 datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, përcaktimin e kriterëve për përfutimin e bursave dhe pagesave për përfutimin e bursave dhe pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike” i ndryshuar, Urdhërit të Kryetarit të bashkisë Nr.439 datë 15.10.2024 “Për shqyrtimin e dokumentacionit për studentët dhe nxënësit aplikant për të përfutur bursë”,

Referuar shkresës së shkollës së mesme profesionale “Rakip Kryeziu”, me nr.24 prot. Datë 10.02.2025 “Problematika lidhur me bursat për vitin 2024-2025”, komisioni për shqyrtimin e dokumentacionit për bursa,

## PROPOZON:

1. Të miratojë listën sipas relacionit bashkëngjitur për një shtesë dhe disa ndryshime, të nxënësve që përfitojnë bursë, të cilët ndjekin programet mësimore në arsimin bazë dhe të mesëm për vitin arsimor 2024-2025”.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Qendra Ekonomike e Arsimit, Bashkia Fier Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit, dhe Shkolla e Mesme Profesionale “Rakip Kryeziu”, Fier.

### Komisioni për shqyrtimin e dokumentacionit për bursa

Olta Brahushi

Xhilda Salaj

Ermioni Gazeli

Drejtor Juridik  
Esmeralda Kapllanaj

Drejtor Finance dhe Kontabiliteti  
Pranvera Çina

KRYETAR  
Armando Subashi

### NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZËVËNDËSKRYETAR

VASIL BREGU

